# Buletini i Njoftimeve Zyrtare
# I REPUBLIKËS SË SHQIPËRISË

www.qbz.gov.al

Viti: 2025 – Numri: 3

Botim i Qendrës së Botimeve Zyrtare


**Tiranë – E hënë, 20 janar 2025**

## PËRMBAJTJA


| | | Faqe |
|---|---|---|
| Kërkesë e Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë nr. 1256, datë 10.1.2025 | Për rihapjen e thirrjes për shprehje interesi për hyrjen në provimin e pranimit në trajnimin fillestar...................................................................... | 3 |
| Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 40, datë 11.1.2025 | Për procedurën konkurruese për kontratën me objekt “Për rikonceptimin e rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, Vila Vlorë”...................................................................................... | 5 |
| Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 40/1, datë 11.1.2025 | Për procedurën konkurruese për kontratën me objekt “Për rikonceptimin e rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, Vila Velipojë”................................................................................ | 9 |
| Kërkesë e Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit nr. 77/5, datë 14.1.2025 | Për shprehje interesi për vendet vakante për përmbarues gjyqësor shtetëror........................................................................................ | 13 |
| Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 51, datë 17.1.2025 | Për ndryshimin e njoftimit të procedurës konkurruese për kontratën “Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i VOID Tower”............. | 14 |
| Njoftim i Korporatës së Investimeve Shqiptare nr. 51/1, datë 17.1.2025 | Për ndryshimin e njoftimit të procedurës konkurruese për kontratën “Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i LIFT Tower”................................. | 15 |
| Kërkesë e Ministrisë së Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale nr. 1/2, datë 17.1.2025 | Për shprehje interesi për shërbimin e konsulencës për kolaudimin e spitalit të Krujës, përfitues i së cilës është Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale........................................................................... | 15 |
| Kërkesë e Agjencisë së Trajtimit të Pronave nr. 238/1, datë 15.1.2025 | Për publikimin e regjistrit të vendimeve, të cilët kanë njohur të drejtën e kompensimit, si dhe vlerësimeve të tyre financiare.............................. | 21 |

**KËRKESË**
**Nr. 1256, datë 10.1.2025**

## PËR RIHAPJEN E THIRRJES PËR SHPREHJE INTERESI PËR HYRJEN NË PROVIMIN E PRANIMIT NË TRAJNIMIN FILLESTAR

Në përputhje me ligjin nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat", dhe urdhrin nr. 702, datë 18.12.2023, të ministrit të Drejtësisë "Për përcaktimin e numrit të vendeve vakante për kandidat përmbarues që do të pranohen në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve për vitin 2023", Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë ka ndjekur procedurat përkatëse ligjore. Në përfundim të tyre, kandidatët që kaluan me sukses provimin e pranimit në Programin e Trajnimit Fillestar u pranuan për të ndjekur programin e detyrueshëm 1-vjeçar 2023, për trajnimin fillestar pranë Qendrës së Trajnimit. Bazuar numrit të kandidatëve që lejon urdhri nr. 702, datë 18.12.2023, i ministrit të Drejtësisë për t'u pranuar në Programin e Trajnimit Fillestar, janë edhe 12 vende kandidatësh për t'u plotësuar.

Në këto kushte, Dhoma Kombëtare e Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë publikon dhe rihap "Thirrjen për shprehje interesi" për hyrjen në provimin e pranimit në trajnimin fillestar.

Numri i vendeve për kandidat përmbarues që do të pranohen në Programin e Trajnimit Fillestar pranë Qendrës Kombëtare të Trajnimit të Përmbaruesve për vitin 2024 është **12 kandidatë.**

Kanë të drejtë të marrin pjesë në provimin e pranimit në trajnimin fillestar kandidatët që plotësojnë **kushtet** si më poshtë, referuar nenit 18, pika 3, të ligjit nr. 26/2019, "Për shërbimin përmbarimor gjyqësor privat":

**1.** Të jetë shtetas shqiptar;

**2.** Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

**3.** Të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose diplomë të njësuar me të, apo të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

**4.** Të mos jetë dënuar me vendim gjyqësor të formës së prerë:

**i.** Për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën nuk është rehabilituar;

**ii.** Për një vepër penale të kryer me pakujdesi, për të cilën nuk është rehabilituar dhe që cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat;

**iii.** Për një vepër penale të kryer me dashje, për të cilën është rehabilituar, kur vepra penale cenon figurën dhe integritetin e profesionit të përmbaruesit gjyqësor privat;

**5.** Të mos jetë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë.

Kandidati që kalon me sukses provimin e pranimit, duke u shpallur fitues për të ndjekur programin e trajnimit fillestar, pranohet për të ndjekur programin e detyrueshëm 1-vjeçar për trajnimin fillestar pranë Qendrës së Trajnimit, përkundrejt pagimit të tarifës së pranimit 300 000 lekë.

Shprehja e interesit duhet të depozitohet brenda datës **28.1.2025** në **rrugë postare**, në **adresën** e selisë së Dhomës Kombëtare, rruga "Nikolla Jorga", ndërtesa 9, kati II, Tiranë, shoqëruar me **dokumentacionin si vijon:**

**1.** Kërkesë për shprehje interesi, me arsyet përkatëse që mbështesin pjesëmarrjen në këtë provim;

**2.** Jetëshkrim;

**3.** Kopje e kartës së identitetit;

**4.** Kopje e njësuar e diplomës që vërteton përfundimin e programit të ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit, ose të diplomës së njësuar me të, apo të diplomës që vërteton përfundimin e studimeve universitare për drejtësi jashtë vendit, të njohur dhe të njësuar, sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë;

**5.** Certifikatë e gjendjes gjyqësore e muajit në të cilin bëhet aplikimi;

**6.** Kopje e njësuar e librezës së punës dhe vërtetimeve të Institutit të Sigurimeve Shoqërore, që vërtetojnë vjetërsinë në punë;

**7.** Vërtetim nga punëdhënësit që nuk janë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik, me vendim të organit kompetent që ka marrë formë të prerë.

**8.** Mandatpagesën për aplikimin dhe dorëzimin e dokumentacionit, 10 000 lekë, si tarifë aplikimi që do të paguhet në llogarinë bankare:

***Emri i institucionit: Qendra Kombëtare e Trajnimit të Përmbaruesve***

***Emri i bankës: Intesa Sanpaolo Bank***

***Nr. i llogarisë: 1060 5318 02 IBAN: AL 8020 8110 0800 0000 1060 5318 02***

***Përshkrimi: Pagesë për aplikim dhe dorëzim dokumentacioni të (Emër Mbiemër)***

Kandidatët që përmbushin kushtet për t'u pranuar në provim, do të njoftohen përmes publikimit të listës emërore në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, brenda 10 ditëve nga mbyllja e afatit të aplikimit.

Provimi i pranimit në formimin fillestar do të zhvillohet në datën **31.1.2025**, ora **10:00**, pranë selisë së Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë ose në një ambient tjetër të caktuar dhe njoftuar prej saj, në varësi të numrit të kandidatëve, aplikantë që do të marrin pjesë në provim. Listat emërore të kandidatëve do të afishohen ditën e provimit pranë ambienteve të zhvillimit të provimit.

Rregullat e detajuara për zhvillimin e provimit të pranimit, për kontrollin e njohurive dhe fusha e testimit, janë sipas përcaktimeve të urdhrit nr. 364, datë 31.5.2021, të ministrit të Drejtësisë, "Për miratimin e 'Programit të detyrueshëm për trajnimin fillestar'", publikuar edhe në Fletoren Zyrtare.

Kjo thirrje shpallet në Buletinin e Njoftimeve Zyrtare, në faqen zyrtare të Dhomës Kombëtare të Përmbaruesve Gjyqësorë Privatë dhe të Ministrisë së Drejtësisë, sipas përcaktimeve ligjore.



# NJOFTIM
## Nr. 40, datë 11.1.2025

## PËR PROCEDURËN KONKURRUESE PËR KONTRATËN ME OBJEKT "PËR RIKONCEPTIMIN E REZIDENCAVE QEVERITARE NË STRUKTURA AKOMODIMI ELITAR, VILA VLORË"

| | |
|---|---|
| **Zhvilluesi i projektit të investimit:** | Korporata e Investimeve Shqiptare |
| **Projekti i investimit:** | Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave shtetërore |
| **Nënprojekti i investimit:** | Hospitality Albania |
| **Konkursi i projektimit:** | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit |
| **Titulli i kontratës:** | Për rikonceptimin e rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, Vila Vlorë |

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu "Korporata", është një shoqëri tregtare aksionare, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksionar të vetëm ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.

2. Korporata, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 9.1.2025, "Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e nënprojekteve 'Copëzat', 'Hospitality' dhe 'Godina e re e Bibliotekës Kombëtare', pjesë e projektit të investimit 'Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore'", në funksion të realizimit të projektit të investimit është autorizuar për të vepruar si zhvilluese e pronave shtetërore të përcaktuara në këtë vendim.

3. Ky projekt synon ripërdorimin dhe modernizimin e rezidencave qeveritare, të cilat aktualisht janë struktura të amortizuara me përdorim sporadik dhe kërkesa të larta për mirëmbajtje, duke i kthyer ato në destinacione ekskluzive dhe tërheqëse për turizmin elitar dhe pritjen e personaliteteve të rëndësishme. Nisma synon të çlirojë dhe të maksimizojë potencialin e këtyre aseteve të veçanta, duke i integruar në tregun fitimprurës global të turizmit, një sektor kyç për të ardhmen e zhvillimit të Shqipërisë. Projekti i investimit realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e ndërmjetësuesit midis institucionit publik, që ka interes të zhvillojë pronën e tij dhe të përfitojë godina bashkëkohore, dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe ekzekutive në aktivitetin e menaxhimit të strukturave hoteliere, dhe ka interes në realizimin e projektit të investimit.

4. Korporata zhvillon këtë procedurë konkurruese në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), e cila, duke përdorur ekselencën e saj disavjeçare, ka përgatitur termat e referencës dhe kriteret e vlerësimit për projektidetë arkitekturore, që do të propozohen nga aplikantët për këtë projekt, të cilat mund të konsultohen në seksionin IV, nënseksioni 2, "Termat e referencës për projektidetë arkitekturore", të "Dokumentit të kualifikimit".

5. Konkurrimi për përzgjedhjen e partnerit privat do të kryhet nëpërmjet procedurës konkurruese përzgjedhëse me pikëzim, me 2 (dy) faza/3 (tri) zarfe, përkatësisht faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në "Rregulloren për procedurën e konkurrimit", të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës: link. Procedura është e hapur për të gjitha subjektet, persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendës apo të huaj.

6. Aplikantët mund të aplikojnë në bashkëpunim me nënkontraktorë të specializuar të përzgjedhur nga vetë ata. Aplikantët mund të përdorin kualifikimet e nënkontraktorëve të specializuar, për të plotësuar kushtet e kualifikimit në lidhje me shërbime të lidhura apo pjesë të kontratës, në përputhje më përcaktimet për "Nënkontraktorët e specializuar" në seksionin I, "Udhëzimet për aplikantët" në "Dokumentin e kualifikimit" dhe seksionin IV, nënseksioni 5, "Nënkontraktorët e specializuar", të "Dokumentit të kualifikimit".

7. "Dokumenti i kualifikimit" është i hartuar në gjuhët shqip dhe anglisht dhe është publikuar në faqen e internetit të Korporatës: link.

8. Faza e kualifikimit (faza I) konsiston në paraqitjen e një aplikimi nga subjektet e interesuara, aplikim i cili përmban projektidenë paraprake arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, dhe dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve dhe të kritereve teknike dhe të kualifikimit të aplikantëve.

9. Faza e përzgjedhjes (faza II) konsiston në paraqitjen e një propozimi, i cili përmban dy zarfe të ndara: a) zarfi i parë përmban projektidenë arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave

qeveritare në struktura akomodimi elitar; dhe b) zarfi i dytë përmban ofertën financiare, siç detajohet në "Ftesën për propozim". Kjo fazë synon përzgjedhjen e projektidesë arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar dhe të propozimit financiar më të favorshëm për Korporatën të paraqitur nga një partner i kualifikuar.

10. Ky "Njoftim i procedurës konkurruese" hap fazën e parë të procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit. Në këtë fazë do të kualifikohen 5 (pesë) kandidatë, të cilët:

- plotësojnë kriteret teknike dhe të kualifikimit;

- do të paraqesin projektidenë paraprake arkitekturore të projektit, e cila renditet në 5 (pesë) projektidetë më të vlerësuara;

- marrin përsipër, nëse përzgjidhen, të plotësojnë angazhimet si vijon, të cilat përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së enfiteozës:

i. angazhimin për pagesën e shpenzimeve të konkursit ndërkombëtar të përzgjedhjes së projektidesë arkitekturore për projektin;

ii. angazhimin për pagesën e vlerës së projektit fitues të konkursit;

iii. angazhimin e pagesës së vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të aplikimit për leje ndërtimi/zhvillimi të projektit përmirësues të pronës nëse është i zbatueshëm;

iv. angazhimi për regjistrimin e pronës së regjistruar me shpenzimet e aplikantit;

v. angazhimin për dhënien e tarifave preferenciale për klientë të përcaktuar në marrëveshje me partnerin publik.

11. Vetëm kandidatët e kualifikuar në fazën e parë do të ftohen në fazën e dytë të konkurrimit nëpërmjet dërgimit të "Ftesës për propozim". Faza e dytë e përzgjedhjes së kandidatit fitues për kontratën konsiston në paraqitjen e një propozimi që përmban 2 (dy) pjesë: projektidenë arkitekturore (zarfi 1) dhe ofertën financiare (zarfi 2). Ofertat financiare të paraqitura nga kandidatët në këtë fazë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është 813,000 (tetëqind e trembëdhjetë mijë) lekë në muaj.

12. Vlerësimi i propozimit kryhet në dy etapa nëpërmjet një konkursi të hapur publik në praninë e një jurie ndërkombëtare. Në etapën e parë vlerësohen projektidetë arkitekturore të konceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar dhe jepen çmimet për 5 projektidetë e propozuara arkitekturore. Në etapën e dytë vlerësohen ofertat financiare në zbatim të metodologjisë së përzgjedhjes së kandidatit fitues të kontratës përcaktuar në seksionin II, pikat 6 dhe 7, të "Dokumentit të kualifikimit", ku vlen të theksohet se kriteri përzgjedhës është:

a) Çmimi më i lartë i enfiteozës i ofruar për Korporatën mbi kriterin bazë.

Çmimi i enfiteozës do të jetë një pagesë mujore dhe aplikohet pas certifikimit të vlerës së investimit të përmirësimit të pronës nga partneri privat.

13. Afati i enfiteozës është 10 vjet, me të drejtë rinovimi deri në kthimin e vlerës së investimit. Pas përfundimit të kontratës së enfiteozës, palët kanë të drejtë të lidhin një marrëveshje partneriteti për menaxhimin e strukturës akomoduese

14. Kontrata fitohet nga subjekti që është vlerësuar nga juria me çmimin e parë të projektidesë arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, nëse ka paraqitur një ofertë financiare, me çmimin më të lartë të ofruar për Korporatën, mbi kriterin bazë, sipas përcaktimeve të kriterit përzgjedhës.

15. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë, gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00–17:00 CET (ora lokale) apo në adresën e *e-mail*-it: competition@aicorporation.al.

16. Aplikimet duhet të përgatiten dhe dorëzohen në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentet shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht, duhet të përkthehen në njërën nga këto gjuhë.

17. Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht me *e-mail*, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri në datë **28 shkurt 2025, ora 15:00 CET (ora lokale)**. Hapja e aplikimeve do të bëhet menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtme:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova" 5, Sky Tower 7/1, Tiranë, Shqipëri

E-mail: competition@aicorporation.al

Adresa e faqes së internetit: https://aicorporation.al/

## Notice of the Competition Procedure

| | |
|---|---|
| **Developer of Investment Project:** | Albanian Investment Corporation |
| **Investment Project:** | Development and Management of State-Owned Properties |
| **Investment Sub-Project:** | Hospitality Albania |
| **Design Competition:** | National Territorial Planning Agency |
| **Contract Title:** | For the re-conceptualization of government residences into elite accommodation structures, in Vlora's Villa |

1. The Albanian Investment Corporation, referred to as "the Corporation", is a new joint-stock company with 100% state capital, whose sole shareholder is the Ministry of Economy, Culture and Innovation of the Republic of Albania.

2. The Corporation, through the Council of Ministers' Decision no. 12, dated 09.01.2025, "On the transfer to the Albanian Investment Corporation of state-owned properties under the administrative responsibility of certain state institutions, for the implementation of the subprojects 'Copëzat', 'Hospitality', and 'The New Building of the National Library', as part of the investment project 'For the Development and Management of State-Owned Properties'" has been authorized to act as the developer for the state-owned properties specified in this decision.

3. This project aims to repurpose and modernize government residences, which are currently underutilized, outdated structures with high maintenance demands, transforming them into exclusive and attractive destinations for elite tourism and hosting distinguished personalities. The initiative seeks to unlock and maximize the potential of these unique assets by integrating them into the lucrative global tourism market, a key sector for Albania's future development. The investment project is implemented through a partnership model, where the Corporation acts as an intermediary between the public institution, which has an interest in developing its property and benefiting from contemporary facilities, and the private partner, who possesses the financial, human, and operational resources in the activity of managing hotel structures and is interested in realizing the investment project.

4. The Corporation conducts this competitive procedure in collaboration with the National Territorial Planning Agency (AKPT), which, leveraging its years of expertise, has prepared the terms of reference and evaluation criteria for the architectural project ideas to be proposed by applicants for this project. These can be consulted in Section IV, Subsection 2, "Terms of Reference for Architectural Project Ideas", of the Qualification Document.

5. The competition for selecting the private partner will be conducted through a competitive selection procedure with scoring, structured in 2 (two) phases/3 (three) envelopes, namely the qualification phase and the selection phase, as specified in the "Regulation for the Competition Procedure", published on the Corporation's official website: link. The procedure is open to all entities, whether individuals or legal entities, private or public, domestic or foreign.

6. Applicants may apply in collaboration with Specialized Subcontractors selected by them. Applicants may utilize the qualifications of Specialized Subcontractors to meet the qualification requirements related to specific services or parts of the contract, in accordance with the provisions for "Specialized Subcontractors" outlined in Section I, Instructions to Applicants, of the Qualification Document, and in Section IV, Subsection 5, Specialized Subcontractors, of the Qualification Document.

7. The Qualification Document is prepared in Albanian and English and is published on the Corporation's website: link.

8. The qualification phase (Phase I) involves the submission of an application by interested entities. This application must include a preliminary architectural concept proposal for the re-conceptualization of government residences into elite accommodation structures, along with documentation verifying compliance with the technical requirements and qualification criteria of the applicants.

9. The selection phase (Phase II) involves the submission of a proposal containing two separate envelopes: (a) the first envelope includes the architectural concept proposal for the re-conceptualization of government residences into elite accommodation structures, and (b) the second envelope includes the financial offer, as detailed in the Invitation for Proposal. This phase aims to select the architectural concept proposal for the re-

conceptualization of government residences into elite accommodation structures and the most favorable financial proposal for the Corporation submitted by a qualified partner.

10. This Notice of the Competitive Procedure opens the first phase of the competitive procedure for selecting the Partner. In this phase, 5 (five) candidates will be qualified, who:

- meet the technical and qualification criteria;
- present the preliminary architectural project idea, which is ranked among the 5 (five) most highly evaluated project ideas;
- commit, if selected, to fulfill the following obligations, which constitute the preliminary conditions of the enfiteusis contract:

a) commitment to pay the costs of the international competition for selecting the architectural concept proposal for the project;

b) commitment to pay the value of the winning project from the competition;

c) commitment to pay the costs of taxes, fees, and contributions related to the application for the construction/development permit for the property enhancement project, if applicable;

d) commitment to register the property, with all registration expenses covered by the applicant;

e) commitment to provide preferential rates for specific clients as agreed with the public partner.

11. Only the candidates qualified in the first phase will be invited to participate in the second phase of the competition through the issuance of the Invitation for Proposal. The second phase of selecting the winning candidate for the contract involves the submission of a proposal containing two (2) separate parts: the architectural concept proposal (Envelope 1) and the financial offer (Envelope 2). The financial offers submitted by candidates in this phase must meet the base criterion, which is 813,000 (eight hundred and thirteen thousand) Lek per month.

12. The evaluation of proposals is conducted in two stages through an open public competition in the presence of an international jury. In the first stage, the architectural concept proposals for the reimagining of government residences into elite accommodation structures are evaluated, and awards are granted for the top 5 architectural concept proposals. In the second stage, financial offers are assessed in accordance with the selection methodology for determining the winning candidate for the contract, as outlined in Section II, points 6 and 7, of the Qualification Document. It is important to note that the selection criterion is:

a. the highest enfiteusis price offered to the Corporation above the base criterion.

The enfiteusis price will be a monthly payment applied after the completion of the property improvement investment by the private partner.

13. The term of the emphyteusis is 10 years, with the right of renewal until the return of the investment value. After the completion of the emphyteusis contract, the parties have the right to enter into a partnership agreement for the management of the accommodation structure.

14. The contract will be awarded to the entity that has been rated first by the Jury for the architectural concept proposal of re-conceptualizing government residences into elite accommodation structures, provided that they have submitted a financial offer with the highest enfiteusis price offered to the Corporation, exceeding the base criterion, as defined by the selection criteria.

15. Interested parties can obtain further information from the Corporation at the address below during working days, from 09:00 to 17:00 CET (local time), or at the e-mail address: competition@aicorporation.al.

16. Applications must be prepared and submitted in Albanian or English. The accompanying documents of the application, if in a language other than Albanian or English, must be translated into one of these languages.

17. Applications must be submitted electronically via e-mail, in person, or by post to the address below, no later than **15:00 CET (local time), on February 28, 2025**. The opening of applications will take place immediately after the deadline for submission at the address below:

Albanian Investment Corporation
Address: Rruga "Ibrahim Rugova" 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania
E-mail: competition@aicorporation.al
Website: https://aicorporation.al/

**NJOFTIM**
**Nr. 40/1, datë 11.1.2025**

**PËR PROCEDURËN KONKURRUESE PËR KONTRATËN ME OBJEKT "PËR RIKONCEPTIMIN E REZIDENCAVE QEVERITARE NË STRUKTURA AKOMODIMI ELITAR, VILA VELIPOJË"**

| | |
|---|---|
| **Zhvilluesi i projektit të investimit:** | Korporata e Investimeve Shqiptare |
| **Projekti i investimit:** | Zhvillimi dhe menaxhimi i pronave shtetërore |
| **Nënprojekti i investimit:** | Hospitality Albania |
| **Konkursi i projektimit:** | Agjencia Kombëtare e Planifikimit të Territorit |
| **Titulli i kontratës:** | Për rikonceptimin e rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, Vila Velipojë |

1. Korporata e Investimeve Shqiptare, këtu "Korporata", është një shoqëri tregtare aksionare, me kapital 100% shtetëror, e cila ka si aksionar të vetëm ministrinë përgjegjëse për ekonominë të Republikës së Shqipërisë.

2. Korporata, nëpërmjet vendimit të Këshillit të Ministrave nr. 12, datë 9.1.2025, "Për transferimin te Korporata e Investimeve Shqiptare të pronave shtetërore, në përgjegjësi administrimi të disa institucioneve shtetërore, për realizimin e nënprojekteve 'Copëzat', 'Hospitality' dhe 'Godina e re e Bibliotekës Kombëtare', pjesë e projektit të investimit 'Për zhvillimin dhe menaxhimin e pronave shtetërore'", në funksion të realizimit të projektit të investimit është autorizuar për të vepruar si zhvilluese e pronave shtetërore të përcaktuara në këtë vendim.

3. Ky projekt synon ripërdorimin dhe modernizimin e rezidencave qeveritare, të cilat aktualisht janë struktura të amortizuara me përdorim sporadik dhe kërkesa të larta për mirëmbajtje, duke i kthyer ato në destinacione ekskluzive dhe tërheqëse për turizmin elitar dhe pritjen e personaliteteve të rëndësishme. Nisma synon të çlirojë dhe të maksimizojë potencialin e këtyre aseteve të veçanta, duke i integruar në tregun fitimprurës global të turizmit, një sektor kyç për të ardhmen e zhvillimit të Shqipërisë. Projekti i investimit realizohet nëpërmjet një modeli partneriteti, ku Korporata ka rolin e ndërmjetësuesit midis institucionit publik, që ka interes të zhvillojë pronën e tij dhe të përfitojë godina bashkëkohore, dhe partnerit privat, që posedon burimet financiare, njerëzore dhe ekzekutive në aktivitetin e menaxhimit të strukturave hoteliere dhe ka interes në realizimin e projektit të investimit.

4. Korporata zhvillon këtë procedurë konkurruese në bashkëpunim me Agjencinë Kombëtare të Planifikimit të Territorit (AKPT), e cila, duke përdorur ekselencën e saj disavjeçare, ka përgatitur termat e referencës dhe kriteret e vlerësimit për projektidetë arkitekturore, që do të propozohen nga aplikantët për këtë projekt, të cilat mund të konsultohen në seksionin IV, nënseksioni 2, "Termat e referencës për projektidetë arkitekturore", të "Dokumentit të kualifikimit".

5. Konkurrimi për përzgjedhjen e partnerit privat do të kryhet nëpërmjet procedurës konkurruese përzgjedhëse me pikëzim, me 2 (dy) faza/3 (tri) zarfe, përkatësisht faza e kualifikimit dhe faza e përzgjedhjes, siç specifikohet në "Rregulloren për procedurën e konkurrimit", të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës: link. Procedura është e hapur për të gjitha subjektet, persona fizikë ose juridikë, privatë apo publikë, vendës apo të huaj.

6. Aplikantët mund të aplikojnë në bashkëpunim me nënkontraktorë të specializuar të përzgjedhur nga vetë ata. Aplikantët mund të përdorin kualifikimet e nënkontraktorëve të specializuar për të plotësuar kushtet e kualifikimit, në lidhje me shërbime të lidhura apo pjesë të kontratës, në përputhje më përcaktimet për "Nënkontraktorët e specializuar" në seksionin I, "Udhëzimet për aplikantët" në "Dokumentin e kualifikimit" dhe seksionin IV, nënseksioni 5, "Nënkontraktorët e specializuar", të "Dokumentit të kualifikimit".

7. "Dokumenti i kualifikimit" është i hartuar në gjuhët shqip dhe anglisht dhe është publikuar në faqen e internetit të Korporatës: link.

8. Faza e kualifikimit (faza I) konsiston në paraqitjen e një aplikimi nga subjektet e interesuara, aplikim i cili përmban projektidenë paraprake arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, dhe dokumentacionin që vërteton plotësimin e kushteve dhe të kritereve teknike dhe të kualifikimit të aplikantëve.

9. Faza e përzgjedhjes (faza II) konsiston në paraqitjen e një propozimi, i cili përmban dy zarfe të ndara: a) zarfi i parë përmban projektidenë arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave

qeveritare në struktura akomodimi elitar; dhe b) zarfi i dytë përmban ofertën financiare, siç detajohet në "Ftesën për propozim". Kjo fazë synon përzgjedhjen e projektidesë arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar dhe të propozimit financiar më të favorshëm për Korporatën të paraqitur nga një partner i kualifikuar.

10. Ky "Njoftim i procedurës konkurruese" hap fazën e parë të procedurës konkurruese për përzgjedhjen e partnerit. Në këtë fazë do të kualifikohen 5 (pesë) kandidatë, të cilët:

- plotësojnë kriteret teknike dhe të kualifikimit;

- do të paraqesin projektidenë paraprake arkitekturore të projektit, e cila renditet në 5 (pesë) projektidetë më të vlerësuara;

- marrin përsipër, nëse përzgjidhen, të plotësojnë angazhimet si vijon, të cilat përbëjnë kushtet paraprake të kontratës së enfiteozës:

i. angazhimin për pagesën e shpenzimeve të konkursit ndërkombëtar të përzgjedhjes së projektidesë arkitekturore për projektin;

ii. angazhimin për pagesën e vlerës së projektit fitues të konkursit;

iii. angazhimin e pagesës së vlerës së taksave, tarifave dhe kontributeve, në kuadër të aplikimit për leje ndërtimi/zhvillimi të projektit përmirësues të pronës, nëse është i zbatueshëm;

iv. angazhimi për regjistrimin e pronës së regjistruar me shpenzimet e aplikantit;

v. angazhimin për dhënien e tarifave preferenciale për klientë të përcaktuar në marrëveshje me partnerin publik.

11. Vetëm kandidatët e kualifikuar në fazën e parë do të ftohen në fazën e dytë të konkurrimit nëpërmjet dërgimit të "Ftesës për propozim". Faza e dytë e përzgjedhjes së kandidatit fitues për kontratën konsiston në paraqitjen e një propozimi që përmban 2 (dy) pjesë: projektidenë arkitekturore (zarfi 1) dhe ofertën financiare (zarfi 2). Ofertat financiare të paraqitura nga kandidatët në këtë fazë duhet të plotësojnë kriterin bazë, i cili është 288,000 (dyqind e tetëdhjetë e tetë mijë) lekë në muaj.

12. Vlerësimi i propozimit kryhet në dy etapa nëpërmjet një konkursi të hapur publik në praninë e një jurie ndërkombëtare. Në etapën e parë vlerësohen projektidetë arkitekturore të konceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar dhe jepen çmimet për 5 projektidetë e propozuara arkitekturore. Në etapën e dytë vlerësohen ofertat financiare në zbatim të metodologjisë së përzgjedhjes së kandidatit fitues të kontratës përcaktuar në seksionin II, pikat 6 dhe 7, të "Dokumentit të kualifikimit", ku vlen të theksohet se kriteri përzgjedhës është:

a) Çmimi më i lartë i enfiteozës i ofruar për Korporatën mbi kriterin bazë.

Çmimi i enfiteozës do të jetë një pagesë mujore dhe aplikohet pas realizimit të investimit të përmirësimit të pronës nga partneri privat.

13. Afati i enfiteozës është 10 vjet, me të drejtë rinovimi, deri në kthimin e vlerës së investimit. Pas përfundimit të kontratës së enfiteozës, palët kanë të drejtë të lidhin një marrëveshje partneriteti për menaxhimin e strukturës akomoduese.

14. Kontrata fitohet nga subjekti që është vlerësuar nga juria me çmimin e parë të projektidesë arkitekturore të rikonceptimit të rezidencave qeveritare në struktura akomodimi elitar, nëse ka paraqitur një ofertë financiare, me çmimin më të lartë të ofruar për Korporatën, mbi kriterin bazë, sipas përcaktimeve të kriterit përzgjedhës.

15. Të interesuarit mund të marrin informacion të mëtejshëm nga Korporata, në adresën më poshtë, gjatë ditëve të punës, në intervalin 09:00–17:00 CET (ora lokale) apo në adresën e *e-mail*-it: competition@aicorporation.al

16. Aplikimet duhet të përgatiten dhe të dorëzohen në gjuhët shqip ose anglisht. Dokumentet shoqëruese të aplikimit, nëse janë në gjuhë të ndryshme nga gjuhët shqip dhe anglisht, duhet të përkthehen në njërën nga këto gjuhë.

17. Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht me *e-mail*, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri më datë **28 shkurt 2025, ora 15:00 CET (ora lokale)**. Hapja e aplikimeve do të bëhet menjëherë në afatin e fundit për dorëzimin e tyre në adresën e mëposhtme:

Korporata e Investimeve Shqiptare

Adresa: Rruga "Ibrahim Rugova" 5, Sky Tower 7/1, Tiranë, Shqipëri

E-mail: competition@aicorporation.al

Adresa e faqes së internetit: https://aicorporation.al/

## Notice of the Competition Procedure

| | |
|---|---|
| **Developer of Investment Project:** | Albanian Investment Corporation |
| **Investment Project:** | Development and Management of State-Owned Properties |
| **Investment Sub-Project:** | Hospitality Albania |
| **Design Competition:** | National Territorial Planning Agency |
| **Contract Title:** | For the re-conceptualization of government residences into elite accommodation structures, in Velipoja's Villa |

1. The Albanian Investment Corporation, referred to as "the Corporation", is a new joint-stock company with 100% state capital, whose sole shareholder is the Ministry of Economy, Culture and Innovation of the Republic of Albania.

2. The Corporation, through the Council of Ministers' Decision no. 12, dated 09.01.2025, "On the transfer to the Albanian Investment Corporation of state-owned properties under the administrative responsibility of certain state institutions, for the implementation of the subprojects 'Copëzat', 'Hospitality', and 'The New Building of the National Library', as part of the investment project 'For the Development and Management of State-Owned Properties'", has been authorized to act as the developer for the state-owned properties specified in this decision.

3. This project aims to repurpose and modernize government residences, which are currently underutilized, outdated structures with high maintenance demands, transforming them into exclusive and attractive destinations for elite tourism and hosting distinguished personalities. The initiative seeks to unlock and maximize the potential of these unique assets by integrating them into the lucrative global tourism market, a key sector for Albania's future development. The investment project is implemented through a partnership model, where the Corporation acts as an intermediary between the public institution, which has an interest in developing its property and benefiting from contemporary facilities, and the private partner, who possesses the financial, human, and operational resources in the activity of managing hotel structures and is interested in realizing the investment project.

4. The Corporation conducts this competitive procedure in collaboration with the National Territorial Planning Agency (AKPT), which, leveraging its years of expertise, has prepared the terms of reference and evaluation criteria for the architectural project ideas to be proposed by applicants for this project. These can be consulted in Section IV, Subsection 2, "Terms of Reference for Architectural Project Ideas", of the Qualification Document.

5. The competition for selecting the private partner will be conducted through a competitive selection procedure with scoring, structured in 2 (two) phases/3 (three) envelopes, namely the qualification phase and the selection phase, as specified in the "Regulation for the Competition Procedure", published on the Corporation's official website: link. The procedure is open to all entities, whether individuals or legal entities, private or public, domestic or foreign.

6. Applicants may apply in collaboration with Specialized Subcontractors selected by them. Applicants may utilize the qualifications of Specialized Subcontractors to meet the qualification requirements related to specific services or parts of the contract, in accordance with the provisions for "Specialized Subcontractors" outlined in Section I, Instructions to Applicants, of the Qualification Document, and in Section IV, Subsection 5, Specialized Subcontractors, of the Qualification Document.

7. The Qualification Document is prepared in Albanian and English and is published on the Corporation's website: link.

8. The qualification phase (Phase I) involves the submission of an application by interested entities. This application must include a preliminary architectural concept proposal for the re-conceptualization of government residences into elite accommodation structures, along with documentation verifying compliance with the technical requirements and qualification criteria of the applicants.

9. The selection phase (Phase II) involves the submission of a proposal containing two separate envelopes: (a) the first envelope includes the architectural concept proposal for the re-conceptualization of government residences into elite accommodation structures, and (b) the second envelope includes the financial offer, as detailed in the Invitation for Proposal. This phase aims to select the architectural concept proposal for the re-

conceptualization of government residences into elite accommodation structures and the most favorable financial proposal for the Corporation submitted by a qualified partner.

10. This Notice of the Competitive Procedure opens the first phase of the competitive procedure for selecting the Partner. In this phase, 5 (five) candidates will be qualified, who:

- meet the technical and qualification criteria;
- present the preliminary architectural project idea, which is ranked among the 5 (five) most highly evaluated project ideas;
- commit, if selected, to fulfill the following obligations, which constitute the preliminary conditions of the enfiteusis contract:

a) commitment to pay the costs of the international competition for selecting the architectural concept proposal for the project;

b) commitment to pay the value of the winning project from the competition;

c) commitment to pay the costs of taxes, fees, and contributions related to the application for the construction/development permit for the property enhancement project, if applicable;

d) commitment to register the property, with all registration expenses covered by the applicant;

e) commitment to provide preferential rates for specific clients as agreed with the public partner.

11. Only the candidates qualified in the first phase will be invited to participate in the second phase of the competition through the issuance of the Invitation for Proposal. The second phase of selecting the winning candidate for the contract involves the submission of a proposal containing two (2) separate parts: the architectural concept proposal (Envelope 1) and the financial offer (Envelope 2). The financial offers submitted by candidates in this phase must meet the base criterion, which is 288,000 (two hundred and eighty-eight thousand) Lek per month.

12. The evaluation of proposals is conducted in two stages through an open public competition in the presence of an international jury. In the first stage, the architectural concept proposals for the re-imagining of government residences into elite accommodation structures are evaluated, and awards are granted for the top 5 architectural concept proposals. In the second stage, financial offers are assessed in accordance with the selection methodology for determining the winning candidate for the contract, as outlined in Section II, points 6 and 7, of the Qualification Document. It is important to note that the selection criterion is:

a. the highest enfiteusis price offered to the Corporation above the base criterion.

The enfiteusis price will be a monthly payment applied after the completion of the property improvement investment by the private partner.

13. The term of the emphyteusis is 10 years, with the right of renewal until the return of the investment value. After the completion of the emphyteusis contract, the parties have the right to enter into a partnership agreement for the management of the accommodation structure.

14. The contract will be awarded to the entity that has been rated first by the Jury for the architectural concept proposal of re-conceptualizing government residences into elite accommodation structures, provided that they have submitted a financial offer with the highest enfiteusis price offered to the Corporation, exceeding the base criterion, as defined by the selection criteria.

15. Interested parties can obtain further information from the Corporation at the address below during working days, from 09:00 to 17:00 CET (local time), or at the e-mail address: competition@aicorporation.al.

16. Applications must be prepared and submitted in Albanian or English. The accompanying documents of the application, if in a language other than Albanian or English, must be translated into one of these languages.

17. Applications must be submitted electronically via e-mail, in person, or by post to the address below, no later than **15:00 CET (local time), on February 28, 2025**. The opening of applications will take place immediately after the deadline for submission at the address below:

Albanian Investment Corporation

Address: Rruga "Ibrahim Rugova" 5, Sky Tower 7/1, Tirana, Albania

E-mail: competition@aicorporation.al

Website: https://aicorporation.al/

**KËRKESË**
**Nr. 77/5, datë 14.1.2025**

## PËR SHPREHJE INTERESI PËR VENDET VAKANTE PËR PËRMBARUES GJYQËSOR SHTETËROR

Në mbështetje të ligjit nr. 8678, datë 14.5.2001, "Për organizimin dhe funksionimin e Ministrisë së Drejtësisë", të ndryshuar; të neneve 12, 16, 17, 33 të ligjit nr. 8, datë 2.2.2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror", të urdhrit nr. 222, datë 14.12.2023, të Kryeministrit, "Për miratimin e strukturës dhe organikës së Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror", të ndryshuar; të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 167, datë 25.3.2024, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin dhe funksionimin e Këshillit të Përmbarimit"; të urdhrit nr. 432, datë 30.6.2023, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit dhe të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror"; si dhe të urdhrit të ministrit të Drejtësisë nr. 6, datë 8.1.2025, "Për fillimin e procedurave për shpalljen e 2 (dy) vendeve vakante për përmbarues gjyqësor pranë Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror", ***Këshilli i Përmbarimit, shpall thirrjen për shprehje interesi*** për fillimin e procedurave për hyrjen në provimin e pranimit për plotësimin e 2 (dy) vendeve vakante për përmbarues gjyqësor shtetëror në zyrat vendore përmbarimore pranë Shërbimit Përmbarimor Gjyqësor Shtetëror, si më poshtë:

- 1 (një) vend vakant në pozicionin Përmbarues Gjyqësor, Zyra Përmbarimore, Durrës;
- 1 (një) vend vakant në pozicionin Përmbarues Gjyqësor, Zyra Përmbarimore, Kukës.

Kanë të drejtë të marrin pjesë në provimin e pranimit kandidatët që plotësojnë kushtet referuar nenit 16 të ligjit nr. 8, datë 2.2.2023, "Për organizimin dhe funksionimin e Shërbimit të Përmbarimit Gjyqësor Shtetëror", si më poshtë:

a) Të jetë shtetas shqiptar;

b) Të ketë zotësi të plotë juridike për të vepruar;

c) Të ketë përfunduar programin e ciklit të dytë të studimeve universitare për drejtësi brenda vendit ose diplomë të njësuar me të, ose të ketë përfunduar studimet universitare për drejtësi jashtë vendit të njohur, dhe njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë";

d) Të mos jenë dënuar me vendim gjyqësor penal të formës së prerë;

e) Të mos jenë shkarkuar nga ushtrimi i detyrës ose i funksionit publik, me vendim të organit kompetent, që ka marrë formë të prerë;

f) Të mos ketë masë disiplinore në fuqi;

g) Të ketë të paktën tre vjet përvojë profesionale si jurist;

h) Të ketë integritet moral të lartë.

Shprehja e interesit për hyrjen në provimin e pranimit duhet të depozitohet brenda datës **28.1.2025** në (rrugë postare ose edhe fizikisht) në adresën e institucionit të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit, sheshi "Mustafa Kemal Ataturk", Tiranë, shoqëruar me dokumentacionin shoqërues, si vijon:

a) Kërkesë për shprehje interesi dhe arsyet përkatëse të motivimit për pjesëmarrjen në këtë provim;

b) Jetëshkrim;

c) Kopje e kartës së identitetit;

d) Kopje të njësuar me origjinalin e diplomës së ciklit të dytë *(master shkencor ose master profesional me 120 kredite me afat ndjekjeje dyvjeçare)* të studimeve universitare për drejtësi, të lëshuar nga institucionet e arsimit të lartë, të licencuara dhe të akredituara sipas dispozitave në fuqi në kohën e lëshimit të diplomës ose diplomën e të njëjtit cikël, të lëshuar nga një institucion i huaj i arsimit të lartë, të njohur e të njësuar sipas legjislacionit në fuqi për arsimin e lartë në Republikën e Shqipërisë";

e) Vërtetim nga punëdhënësi i fundit dhe/ose organet disiplinore, që nuk është larguar nga detyra ose i është hequr licenca, autorizimi ose leja për ushtrimin e një profesioni për shkaqe disiplinore, si dhe vërtetim që nuk ka masë disiplinore në fuqi;

f) Kopje të njësuar me origjinalin të librezës së punës që të vërtetojë periudhën e vjetërsisë në punë;

g) Vërtetim i gjendjes gjyqësore;

h) Raportin mjekoligjor për aftësimin e tij të përgjithshëm në kuadër të kryerjes së detyrës si përmbarues gjyqësor shtetëror;

i) Dëshmi, vërtetime dhe rekomandime nga persona dhe institucione ku kanë punuar viteve të fundit;

j) Deklaratë që vërteton se nuk është anëtar i partive politike;

k) Çdo dokument tjetër që çmohet i nevojshëm për vërtetimin e përmbushjes së kritereve ligjore për përmbarues gjyqësor shtetëror.

Kandidatët që përmbushin kushtet për t'u pranuar në provimin me shkrim do të njoftohen përmes publikimit të listës emërore në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Drejtësisë, si dhe të Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit brenda 13 (trembëdhjetë) ditëve nga mbyllja e afatit të aplikimit.

Provimi me shkrim do të zhvillohet më datë **24.2.2025, ora 10:00**, në ambientet e Ministrisë së Drejtësisë, me adresë: bulevardi "Zogu i Parë", Tiranë.

Rregullat e detajuara për zhvillimin e provimit të pranimit, për kontrollin e njohurive, fusha e testimit, vlerësimin me pikë dhe mënyrën e llogaritjes së rezultatit përfundimtar janë sipas përcaktimeve në urdhrin e ministrit të Drejtësisë nr. 432, datë 30.6.2023, "Për përcaktimin e rregullave të hollësishme për organizimin, zhvillimin, përmbajtjen e provimit të pranimit, si dhe procedurën e vlerësimit dhe të shpalljes së rezultateve për përmbaruesin gjyqësor shtetëror", publikuar edhe në Fletoren Zyrtare.

Provimi i pranimit vlerësohet me maksimumin e mundshëm 100 (njëqind) pikë, nga të cilat provimi me shkrim përbën 75 (shtatëdhjetë e pesë) pikë të numrit total të pikëve dhe pjesa e provimit me gojë përbën 25 (njëzet e pesë) pikë.

Kandidati që do të vlerësohet me të paktën 60 pikë në pjesën e kontrollit të njohurive me shkrim, kalon në testin e kontrollit të njohurive me gojë.

Lista me kodet dhe pikët e fituara nga kandidatët në provimin me shkrim, publikohet në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit. Publikimi, për efekt ankimi, është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

Data, ora dhe vendi i zhvillimit të testimit me gojë do të publikohet në faqen zyrtare elektronike të Ministrisë së Drejtësisë dhe Drejtorisë së Përgjithshme të Përmbarimit. Publikimi është i barasvlershëm me njoftimin e çdo kandidati.

## NJOFTIM
**Nr. 51, datë 17.1.2025**

## PËR NDRYSHIMIN E NJOFTIMIT TË PROCEDURËS KONKURRUESE PËR KONTRATËN "ZHVILLIMI NËPËRMJET SIPËRMARRJES I VOID TOWER"

| | |
|---|---|
| **Zhvilluesi i Projektit të Investimit:** | Korporata e Investimeve Shqiptare |
| **Emri i projektit:** | Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore |
| **Nënprojekti:** | Ndërtimi dhe menaxhimi i Kompleksit Governativ |
| **Titulli i kontratës:** | Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i VOID Tower |

Korporata e Investimeve Shqiptare njofton të gjithë të interesuarit për një ndryshim në njoftimin e procedurës konkurruese, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës së Investimeve Shqiptare më datë 20 nëntor 2024, për kontratën "Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i VOID Tower", si më poshtë:

1. Pika 13 e njoftimit ndryshon në:

"Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht me e-mail, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri më datë **30 janar 2025, ora 12:00, ora lokale**".

2. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe të aplikantëve shtyhen deri në afatin e rishikuar për dorëzimin e aplikimeve.

## ANNOUNCEMENT

| | |
|---|---|
| **Investment Project Developer:** | Albanian Investment Corporation |
| **Project Name:** | Development and management of state buildings |
| **Sub-project:** | Construction and management of the Government Cluster |
| **Title of the contract:** | Development of VOID Tower |

The Albanian Investment Corporation hereby notifies all interested parties of a modification to the Notice of Competitive Procedure, published on the official website of the Albanian Investment Corporation on November 20, 2024, for the contract titled "Development of VOID Tower," as follows:

1. Point 13 of the Notice of Competitive Procedure is amended to:

"Applications must be submitted electronically via e-mail, in person or by mail to the address below, no later than **January 30, 2025, at 12:00 local time**."

2. All rights and obligations of the Albanian Investment Corporation and the applicants are extended to the revised application submission deadline.

## NJOFTIM
## Nr. 51/1, datë 17.1.2025

## PËR NDRYSHIMIN E NJOFTIMIT TË PROCEDURËS KONKURRUESE PËR KONTRATËN "ZHVILLIMI NËPËRMJET SIPËRMARRJES I LIFT TOWER"

| | |
|---|---|
| **Zhvilluesi i Projektit të Investimit:** | Korporata e Investimeve Shqiptare |
| **Emri i projektit:** | Zhvillimi dhe menaxhimi i godinave shtetërore |
| **Nënprojekti:** | Ndërtimi dhe menaxhimi i godinës së Kadastrës Shqiptare |
| **Titulli i kontratës:** | Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i LIFT Tower |

Korporata e Investimeve Shqiptare njofton të gjithë të interesuarit për një ndryshim në njoftimin e procedurës konkurruese, të publikuar në faqen zyrtare të internetit të Korporatës së Investimeve Shqiptare më datë 20 nëntor 2024, e ndryshuar, për kontratën "Zhvillimi nëpërmjet sipërmarrjes i LIFT Tower", si më poshtë:

1. Pika 13 e njoftimit ndryshon në:

"Aplikimet duhet të dorëzohen elektronikisht me e-mail, dorazi ose me postë, në adresën e mëposhtme, deri më datë **30 janar 2025, ora 15:00, ora lokale**".

2. Të gjitha të drejtat dhe detyrimet e Korporatës së Investimeve Shqiptare dhe aplikantëve shtyhen deri në afatin e rishikuar për dorëzimin e aplikimeve.

## ANNOUNCEMENT

| | |
|---|---|
| **Investment Project Developer:** | Albanian Investment Corporation |
| **Project Name:** | Development and management of state buildings |
| **Sub-project:** | Construction and management of the Albanian Cadaster building |
| **Title of the contract:** | Development of LIFT Tower |

The Albanian Investment Corporation hereby notifies all interested parties of a modification to the Notice of Competitive Procedure, published on the official website of the Albanian Investment Corporation on November 20, 2024, as amended, for the contract titled "Development of LIFT Tower," as follows:

1. Point 13 of the Notice of Competitive Procedure is amended to:

"Applications must be submitted electronically via e-mail, in person or by mail to the address below, no later than **January 30, 2025, at 15:00 local time**."

2. All rights and obligations of the Albanian Investment Corporation and the applicants are extended to the revised application submission deadline.

## KËRKESË
## Nr. 1/2, datë 17.1.2025

## PËR SHPREHJE INTERESI PËR SHËRBIMIN E KONSULENCËS PËR KOLAUDIMIN E SPITALIT TË KRUJËS, PËRFITUES I SË CILËS ËSHTË MINISTRIA E SHËNDETËSISË DHE MBROJTJES SOCIALE

**Tiranë, 20 janar 2025**

**Asistencë Teknike Lokale – Kompani Konsulence**

**Financimi Shtesë i Projektit të Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor Shqiptar (HSIP)**

***Nr. huaje:*** **93060**

***Numri ID i Projektit:*** **P144688**

***Titulli i detyrës:*** Shërbime konsulence për kolaudimin e Spitalit të Krujës

***Numri i referencës*** AL-MH-468729-CS-CQS

Qeveria e Shqipërisë ka marrë financim shtesë, në vlerën 25 milionë euro për Projektin e Përmirësimit të Sistemit Shëndetësor në Shqipëri, një hua të Bankës Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim (IBRD), për të shkallëzuar aktivitetet e projektit mëmë dhe për të siguruar direkt ndikim te përfituesit dhe te përmirësimi i mëtejshëm i ofrimit të shërbimit të kujdesit spitalor në vend. Banka Ndërkombëtare për Rindërtim dhe Zhvillim ("Banka Botërore") vepron si administrator i shumës së dhënë. Ministria e Shëndetësisë (MSHMS), më poshtë referuar si "Klienti", ka përgjegjësinë e përgjithshme për Projektin dhe

Koordinimi i Projektit është përgjegjës për zbatimin e Projektit nëpërmjet Ekipit të tij të Menaxhimit të Projektit (PMT). Objektivi i Projektit është të kontribuojë në modernizimin e shërbimeve të përzgjedhura spitalore publike dhe të mbështesë rindërtimin e objekteve të përzgjedhura mjekësore të dëmtuara nga tërmeti i vitit 2019. Projekti përbëhet nga pjesët e mëposhtme:

Pjesa 1. Përmirësimi i menaxhimit dhe i infrastrukturës së spitaleve

Pjesa 2. Përmirësimi i Menaxhimit të Informacionit Shëndetësor/*e-Shëndetësisë* për shërbimet spitalore

Pjesa 3: Monitorimi, vlerësimi dhe menaxhimi i projektit

Financimi shtesë do të mbështesë më tej reformën spitalore që rrjedh nga Masterplani i Spitaleve, si një parakusht për racionalizimin e nivelit dytësor të kujdesit shëndetësor në Shqipëri dhe përmirësimin e mëtejshëm të efikasitetit dhe të përmirësimit të cilësisë së spitaleve. Urgjenca e racionalizimit dhe e përmirësimit të rrjetit spitalor është shtuar më tej nga dëmtimet e shkaktuara nga tërmeti. Sa më sipër do të bëhet e mundur përmes racionalizimit të spitaleve të mëdha, transformimit të aktiviteteve dhe shërbimeve aktuale spitalore në një institucion shëndetësor më dinamik dhe më vetefikas, duke përdorur një qasje të integruar që adreson rehabilitimin e infrastrukturës, pajisjet moderne diagnostike dhe optimizimin e personelit të kujdesit shëndetësor. Mbështetur në rezultatet e projektit mëmë (si modernizimi i pajisjeve diagnostikuese mjekësore në 11 spitale rajonale, rikonstruksioni i Spitalit Pediatrik në Spitalin Nënë Tereza, godina e re e Spitalit të Laçit) aktivitetet e parashikuara nga financimi shtesë përputhen plotësisht me agjendën e zgjeruar të reformës dhe përmirësimin e mëtejshëm të ofrimit të kujdesit spitalor. Rindërtimi i spitaleve rajonale dhe bashkiake do të japë një mundësi për të zbatuar HMP-në e përditësuar. Rezultatet e projektit mëmë kanë inkurajuar Ministrinë e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale në ndjekjen e një reforme më të thellë në nivelin sekondar të kujdesit, duke filluar me përmirësimin e mëtejshëm të kujdesit diagnostik, optimizimin e plotë të shërbimeve spitalore rajonale dhe transformimin e shërbimeve në spitalet e përzgjedhura bashkiake dhe zbatimin e sistemit të informacionit shëndetësor në spitalet rajonale. Përmirësimi i sistemit të kujdesit shëndetësor spitalor në vend në të gjitha nivelet e tij, duke filluar nga forcimi i menaxhimit dhe i qeverisjes për shërbimet spitalore publike, marrëveshjet e financimit shëndetësor, sistemet e informacionit, për përmirësimin e efikasitetit dhe të cilësisë së kujdesit shëndetësor në Shqipëri vazhdon të jetë një objektiv kryesor për qeverinë e Shqipërisë. Një nga aktivitetet e financuara nga komponenti 1 është aktiviteti për rehabilitimin e mbikëqyrjes dhe validimit të godinës së Spitalit Krujë.

*Kualifikimet e kompanisë konsulente:*

- Kjo detyrë do të kryhet nga një firmë vendëse, e krijuar dhe që funksionon sipas legjislacionit, rregullave dhe rregulloreve shqiptare.
- Kompania Konsulente duhet të ketë të paktën 5 vjet përvojë në fushën e vlefshmërisë së punimeve civile;
- Kompania duhet të sigurojë të paktën dy kontrata të ngjashme (kolaudim i ndërtesave) gjatë pesë vjetëve të fundit. Kjo duhet të verifikohet nëpërmjet: aktit të kolaudimit (komisionimit) ose letrës së referencës nga autoriteti kontraktor ku konfirmohet përfundimi me sukses.
- Aftësi për të komunikuar dhe për të përgatitur dokumentet në të dyja gjuhët: shqip dhe anglisht (vetëdeklarim në CV).
- Jetëshkrimi i firmës konsulente, duke renditur të gjitha përvojat dhe veçanërisht kontratat e ngjashme në vlefshmëri.
- Kompania konsulente duhet të jetë në gjendje të sigurojë në versionin origjinal ose ligjor të certifikuar, licenca të vlefshme profesionale për vlefshmëri, siç përshkruhet më poshtë (nga vetë kompania ose përmes kontratës së nënshkruar ndërmjet kompanisë konsulente dhe individëve/firmave të tjera):

***Licencat për vlefshmëri të kërkuara nga verifikuesi:***

- NP – 1 (Punime e gërmimi në tokë)
- NP – 3 (Rikonstruksion dhe mirëmbajtje ndërtesash civile dhe industriale, veshje fasadash)
- NP – 7 (Ujësjellës, gazsjellës, vajsjellës, vepra kullimi e vaditje)
- NP – 11 (Ndërtime për nënstacionet, kabinat e transformatorëve linja e TN-së e të mesëm dhe shpërndarjen e energjisë)
- NS – 1 (Punime për prishjen e ndërtimeve)
- NS – 2 (Impiante hidrosanitare, kuzhina, lavanteri, mirëmbajtja e tyre)

- NS – 3 (Impiante ngritëse dhe transportuese, ashensorë, shkallë lëvizëse, transportues)
- NS – 12 (Impiante teknologjike, termike dhe të kondicionimit)
- NS – 14 (Impiante të brendshme, elektrike, telefoni, radiotelefoni TV etj.)
- NS – 16 (Ndërtimi i impianteve të ujit të pijshëm dhe pastrimi i tij)

Konsulenti duhet të jetë i certifikuar, për:

*ISO 9001 "Për zbatimin e sistemeve të menaxhimit të cilësisë"; dhe*

*ISO 14001 "Për zbatimin e sistemit të menaxhimit mjedisor".*

**Konsulenti duhet të ketë staf adekuat për të kryer aktivitetet sipas këtij vlerësimi. Kualifikimi i pozicioneve kyçe përfshin:**

Stafi i konsulentëve kryesorë duhet të përbëhet nga stafi i mëposhtëm, të cilët duhet të plotësojnë kriterin përkatës të mëposhtëm.

| Nr. | Pozicioni | Numri i personelit |
|---|---|---|
| 1 | **Menaxher i Projektit** | **1** |
| 2 | **Inxhinier ndërtimi** | **1** |
| 3 | **Inxhinier elektrik** | **1** |
| 4 | **Inxhinier mekanik** | **1** |
| 5 | **Inxhinier hidroteknik** | **1** |

*Kualifikimet e kërkuara për personelin në pozicionin kyç janë dhënë më poshtë:*

**Menaxheri i Projektit:** Msc. Master i shkencave në inxhinieri ndërtimi, me ekspertizë të paktën 6-vjeçare në fushën e validimit të punimeve civile;

**Inxhinier ndërtimi:** Msc. Master i shkencave në inxhinieri ndërtimi, me ekspertizë të paktën 5-vjeçare në fushën e validimit të punimeve civile;

**Inxhinier elektrik:** Msc. Master i shkencave në inxhinieri elektrike civile, me ekspertizë të paktën 5 vjet në fushën e vlefshmërisë së punimeve civile;

**Inxhinier mekanik:** Msc. Master i shkencave në inxhinieri mekanike civile, me ekspertizë të paktën 5 vjet në fushën e vlefshmërisë së punimeve civile;

**Inxhinier hidroteknik:** Msc. Master i shkencave në inxhinieri hidroteknike civile me ekspertizë të paktën 5 vjet në fushën e validimit të punimeve civile.

**Kompania duhet, gjithashtu, të sigurojë CV-të e detajuara të të gjithë ekspertëve të kërkuar më sipër, në të cilat ndër të tjera: CV-ja duhet të detajojë vitet e përvojës së përgjithshme, përvojat e mëparshme të ngjashme në fushën e vlefshmërisë. Përveç kësaj shoqëria do të sigurojë për të gjithë ekspertët e mësipërm licencat profesionale të vlefshme të lëshuara nga autoritetet shqiptare në fushën e ekspertizës së tyre, në versionin origjinal ose të noterizuar.**

**Konsulenti mund të ofrojë, gjithashtu, ekspertë jo kyç.**

**Shënim. Të gjithë ekspertët e mësipërm duhet të kenë licenca profesionale të lëshuara nga autoritetet shqiptare në fushën e ekspertizës së tyre, sipas paragrafit më sipër "Kualifikimi i konsulentëve".**

Firma, e cila do të zgjidhet (pas përmbushjes së kërkesave minimale të kualifikimit/përvojës më lart) si e renditur më lart në bazë të kritereve të vlerësimit/listës së shkurtër më poshtë, do të ftohet për negociata për kontratën, gjatë së cilës, firmave të suksesshme do t'u kërkohet të përmbushin çelësin e mësipërm: kualifikimi i personelit.

Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale, tani fton kompanitë konsulente të kualifikuara ("Konsulentët") të tregojnë interesin e tyre për ofrimin e shërbimeve. Kompanitë Konsulente duhet të ofrojnë informacion që tregon se ato kanë kualifikimet e kërkuara dhe përvojën përkatëse për të kryer shërbimet (siç përshkruhet më sipër). Kriteret e vlerësimit/përzgjedhjes janë:

| Nr. | Kriteri i vlerësimit | Pikët |
|---|---|---|
| 1. | Përvoja e përgjithshme e firmës (numri i viteve) në fushën e detyrës | 30 |
| 2. | Numri i kontratave të lidhura me detyrën e përfunduar gjatë pesë vjetëve të fundit | 60 |
| 3. | Disponueshmëria e stafit kyç të kualifikuar brenda firmës | 10 |
| **TOTALI** | | **100 pikë** |

Konsulenti duhet të jetë një firmë lokale. Metoda e përzgjedhjes që do të aplikohet është **Kualifikimi i Konsulentëve (CQ),** në përputhje me procedurat e përcaktuara nga Banka Botërore "Prokurimi në financimin e projekteve investimetore mallra, punime, shërbime jokonsulente dhe konsulente", botimi i katërt, nëntor 2020. Detyra duhet të kryhet brenda maksimumit 10 ditëve kalendarike nga data e fillimit të shërbimeve (nga data në të cilën klienti ka kërkuar validimin e procesit për të filluar), megjithatë jo më shumë se 30 qershor 2025. **Kontrata do të jetë *lump sum.* Kostot dhe angazhimi i kësaj konsulence janë llogaritur sipas ligjit shqiptar në fuqi.**

Informacione të mëtejshme mund të merren në adresën e mëposhtme gjatë orarit të punës nga 08:00 deri në 16:30 (e hënë në të enjte) dhe nga ora 08:00 deri në 14:00 (të premten) në adresën e mëposhtme. Shprehjet e interesit duhet të dorëzohen me shkrim në adresën e mëposhtme (personalisht, me postë ose me *e-mail)* deri më **3 shkurt 2025.**

**Ministria e Shëndetësisë dhe Mbrojtjes Sociale**
**Adresa: Rruga e Kavajës Tiranë – Shqipëri**
**Njësia e Koordinimit të Projektit (PCU)**
**Projekti për Përmirësimin e Sistemit Shëndetësor (HSIP)**
**Att: Blerina Dudushi**
**E-mail: hsip.dudushi@gmail.com**

## REQUEST FOR EXPRESSIONS OF INTEREST (REOI) (CONSULTING SERVICES)

### Local Technical Assistance- Consulting Company

**Tirana, 20 January 2025**

**Additional Financing of Albania Health System Improvement Project (HSIP)**
***Loan No:* 93060**
***Project ID Number:* P144688**
***Assignment Title:* Consulting Services for the Validation of Kruja Hospital**
***Reference No.* AL-MH-468729-CS-CQS**

The Government of Albania has received additional financing, in the amount of EUR 25 million for the Health System Improvement Project in Albania, a loan of International Bank for Reconstruction and Development (IBRD) to scale – up the activities of the parent project and ensure direct impact to the beneficiaries and further improvement of hospital care service provision in the country. The International Bank for Reconstruction and Development ("World Bank") is acting as administrator of the amount provided. The Ministry of Health (MoHSP) herein after referred as "the Client" has overall responsibility for the Project, and the Project Coordination is responsible for the implementation of the Project through its Project Management Team (PMT). The objective of the Project is to contribute to the modernization of selected public hospital services and to support the reconstruction of selected medical facilities damaged by the 2019 earthquake. The Project consists of the following parts:

Part 1. Improving Hospitals Management and Infrastructure

Part 2. Improving Health Information Management/ e-Health for Hospital Services:

Part 3: Monitoring, Evaluation and Project Management:

The additional financing will further support the hospital reform that derived by the Hospital Master Plan as a prerequisite for the rationalization of secondary level of health care in Albania and further improvement of efficiency and quality enhancement of hospitals. The urgency of rationalization and upgrading of the hospital network has been further heightened by the damaged caused by the earthquake. The above will be made possible through the rationalization of oversized hospitals, transformation of current hospital activities and services to a more dynamic and self - efficient health care institution using an integrated approach addressing infrastructure rehabilitation, modern diagnostic equipment and optimization of health care personnel. Building on the results of the parent project (such as the modernization of medical diagnostic equipment's in 11 regional hospitals, reconstruction of the Pediatric hospital at Mother Theresa hospital, the new building of Laç hospital) the activities foreseen under additional financing are fully aligned with the extended reform agenda and further improvement of hospital care provision. The reconstruction of the regional and municipal hospitals will give an opportunity to implement the updated HMP. The outcomes of the parent project have encouraged the Ministry of Health and Social Protection in pursuing a deeper reform in the secondary level of care starting with the further improvement of diagnostic care, full optimization of regional hospital services, and transformation of services in selected municipality hospitals and implementation of health information system in regional hospitals. The improvement of the hospital health care system in the country in all its tiers starting from strengthening management and governance for public hospital services, health financing arrangements, information systems, for improved efficiency and quality of health care in

Albania continues to be a main objective for the government of Albania. One of the activities financed under component 1 is the Activity for Rehabilitation supervision and validation of Kruja Hospital building.

*Qualifications of the Consulting Company:*

- This assignment will be carried about by a Local firm, established and operating according to the Albania legislation, rules and regulations.

- The Consulting Company should have at least 5 years of experience in the area of validation of civil works;

- The company must provide at least two similar contracts (validation of buildings) during the last five years. This must be verified through: Validation (Commissioning) Act or Reference Letter from the Contracting Authority where the successful completion is confirmed.

- Ability to communicate and prepare the documents in both languages Albanian and English (self-declaration in CV).

- The curriculum vitae of the consulting firm, listing all the experiences and especially similar contracts in validation.

- The consulting Company should be able to provide in original or legal certified version, valid professional licenses for validation as below described (from the company itself or through signed contract between the consulting company and other individual/firms):

***Licenses for validation required from the validator:***

- NP – 1 (Excavation works on land)

- NP – 3 (Reconstruction and maintenance of civil and industrial buildings, cladding of facades)

- NP – 7 (Water pipelines, gas pipelines, oil pipelines, drainage and irrigation work)

- NP – 11(Buildings for N/Stations, transformer rooms, medium voltage lines and power distribution)

- NS – 1 (Works for demolition of buildings)

- NS – 2 (Hydro-sanitary Plants, Kitchens, Washers, Maintenance)

- NS – 3 (Lifting Conveyor System)

- NS – 12 (Technological, thermal and air conditioning plants)

- NS – 14 (Domestic, electrical, telephone, radiotelephone, TV, etc.)

- NS – 16 (Construction of drinking water plants and its purification)

The consultant should be certified for:

*ISO 9001 "For implementation of the quality management systems"; and*

*ISO 14001 "For implementation of the environmental management system".*

**The consultant must have adequate staff to perform the activities under this assessment. The qualification of the key positions includes:**

Key consultant's staff should be composed by the following staffs which should meet the following respective criterion.

| No. | Position | No. of personnel |
|---|---|---|
| 1 | **Project Manager** | **1** |
| 2 | **Civil engineer** | **1** |
| 3 | **Electrical engineer** | **1** |
| 4 | **Mechanical engineer** | **1** |
| 5 | **Hydro technical Engineer** | **1** |

*The required qualifications for the personnel in key position are given below:*

**Project Manager**: Msc. Master of Science in civil engineer with at least 6 years expertise in the area of validation of civil works;

**Civil Engineer**: Msc. Master of Science in civil engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works;

**Electrical Engineer**: Msc. Master of Science in civil electrical engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works;

**Mechanical Engineer**: Msc. Master of Science in civil mechanical engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works;

**Hydro technical Engineer**: Msc, Master of science in civil hydro technical engineer with at least 5 years expertise in the area of validation of civil works.

**The company must also provide the detailed CVs of all above required experts in which among others, the CV must detail the years of general experience, the past similar experiences in the field of validation. In addition, the company shall provide for all the above experts the valid professional Licenses issued by Albanian Authorities in the field of their expertise, in original or notarized version.**

**The consultant may provide also non-key experts.**

**Note: All the above experts should have professional Licenses issued by Albanian**

**Authorities in the field of their expertise as per point 7 above "Consultants qualification**

The firm who will be selected (after fulfilling the minimum qualification/experience requirements above) as highest ranked based on the evaluation/shortlisting criteria below, will be invited for contract negotiations, during which, the successful firms will be required to fulfill the above key staff qualification.

The Ministry of Health and Social Protection, now invites eligible consulting companies ("Consultants") to indicate their interest in providing the Services. Consulting Companies should provide information demonstrating that they have the required qualifications and relevant experience to perform the Services (as described above). The evaluation/shortlisting criteria are:

| No. | Evaluation Criterion | Points |
|---|---|---|
| 1. | Overall experience of the firm (number of years) in the field of assignment | 30 |
| 2. | Number of assignment-related contracts completed during last five years. | 60 |
| 3. | Availability of qualified key staff within the firm | 10 |
| **TOTAL** | | **100 points** |

The consultant should be a Local Firm. The selection method to be applied is **Consultants Qualification (CQ)** in accordance with the procedures set out the World Bank's PROCUREMENT IN INVESTMENT PROJECT FINANCING Goods, Works, Non-Consulting and Consulting Services Fourth Edition November 2020. The assignment should be performed within maximum 10 calendar days form the date of start of the services (from the date in which the Client has requested the validation process to start), however not longer than 30 June 2025. **The contract will be Lump Sum. The costs and input of this consultancy are calculated as per the applicable Albanian Law.**

Further information can be obtained at the address below during office hours 08:00 to 16:30 (Monday to Thursday) and 08:00 to 14:00 on Friday in the address below). Expressions of interest must be delivered in a written form to the address below (in person, or by mail, or by e-mail) by **03 February 2025.**

**Ministry of Health and Social Protection**
**Adress: Rruga e Kavajës Tirana – Albania**
**Project Coordination Unit (PCU)**
**Health System Improvement Project (HSIP)**
**Att: Blerina Dudushi**
**E-mail: hsip.dudushi@gmail.com**

**KËRKESË**
**Nr. 238/1, datë 15.1.2025**

**PËR PUBLIKIMIN E REGJISTRIT TË VENDIMEVE, TË CILËT KANË NJOHUR TË DREJTËN E KOMPENSIMIT, SI DHE VLERËSIMEVE TË TYRE FINANCIARE**

Agjencia e Trajtimit të Pronave ju njofton, se referuar nenit 19 "Ankimi ndaj vlerësimit financiar", të ligjit nr. 133/2015: "Çdo palë e interesuar ka të drejtë të ankohet kundër vlerësimit financiar të kryer nga ATP-ja për përcaktimin e vlerës së pronës në Gjykatën Administrative të Apelit brenda 30 ditëve nga dita e publikimit, vetëm për vlerën e kompensimit."

## VENDIMET ME TË DREJTË PARABLERJEJE, QË SIPAS LIGJIT NR. 133/2015 JANË VLERËSUAR SI TË SHLYERA DHE QË ME LIGJIN NR. 77/2020 REZULTOJNË ME VLERË

| Nr. Rendor | Data/ Dosje | Qarku | Bashkia | Qyteti/ Fshati | Emri *(Subjekti i shpronësuar)* | Atësia | Mbiemri *(Subjekti i shpronësuar)* | Emri *(Subjekti kërkues)* | Atësia | Mbiemri *(Subjekti kërkues)* | Nr. vendimi i KKKP-së, ZRKKP-së | Dita, vendimi i KKKP-së, ZRKKP-së | Muaji, vendimi i KKKP-së, ZRKKP-së | Viti, vendimi i KKKP-së, ZRKKP-së | Sipërfaqe e njohur/ mosnjohur | Sipërfaqe e kthyer | Sipërfaqe e kompensuar | E drejtë parablerjeje | Nr. vendimi i AKKP-së / ATP-së | Dita, vendimi i AKKP-së / ATP-së | Muaji, Vendimi i AKKP / ATP | Viti, vendimi i AKKP-së / ATP-së | Sip. e njohur/mosnjohje | Sip. e kthyer | Sip. për kompensim m² | Vendim gjykate, SHK I | Vendim Gjykate, SHK II | Vendim Gjykate, e Lartë |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 1 | 1993 | TIRANE | TIRANE | TIRANE | MEHMET | OC | KELLEZI | MUHAMET | | KELLEZI | 102 | 15 | 10 | 1993 | 11991.6 | 1052 | 1763.6 | 9176 | | | | | | | | | | |
| 2 | 09.12.1993 | Elbasan | Elbasan | Elbasan | Beqir | | Bajraktari | Abazali | | Bajraktari | 105/2 | 16 | 12 | 1993 | 14000 | 1120 | pjesa qe do mbetet pas blerjes se objekteve | 5870 | | | | | | | | | | |
| 3 | 03.04.2007 | Korçë | POGRADEC | POGRADEC | SAMI | SEJAT | BERBERI | SAMI | SEJAT | BERBERI | 92 | 24 | 3 | 1994 | 1537 | 96 + 168.5 bashkpronesi dhe sipas nenit 12 | 444 | 18.5 | | | | | | | | | | |
| 4 | 17-01-1994 | DURRES | Durrës | Durres | Shadije Bogdo, Sulo Bogdo | | | Erik Shehu | | | 405 | 1 | 4 | 1994 | 657 | 157.5 | 0 | 499.5 | Nr:1084,Dt:29-10-2011,Institucioni:AKKP | | | | | | | | | |
| 5 | 01-01-1994 | Kukës | Tropojë | Bajram Curri | Bajram Selim Mustafaj | | | Bajram Selim Mustafa | | | 3 | 4 | 5 | 1994 | 26480 | 2993 | 0 | 23487 | | | | | | | | | | |
| 6 | 28.03.1994 | SHKODER | SHKODER | SHKODER | ISA | BALO | HALLUNI | ISA | | HALLUNI | 220 | 17 | 5 | 1994 | 2240 | 924 | | 1316M2 ZENE NGA NDERMARRJA E AGROEKSPORTIT | | | | | | | | | | |
| 7 | 16-11-1993 | SHKODER | Shkodër | | Shuke Ndrek Kabashi | | | Injac Kabashi | | | 228 | 24 | 5 | 1994 | | 660 | 62 | 2140 | | | | | | | | | | |
| 8 | 01-01-1994 | Lezhë | Kurbin | | Arap Gjergji | | | Pashk Llesh Nokaj | | | 20 | 22 | 6 | 1994 | 7762 | 1312 | 560 | 853.5 | | | | | | | | | | |
| 9 | 11.08.1994 | Elbasan | Elbasan | Elbasan | Dhimiter | | Shuqja | Dhimiter | | Shuqja | 385/2 | 5 | 9 | 1994 | 12500 | 5000 | 600 | Ne baze te nenit 21, i lind e drejta e parablerjes kur te privatizohet Kombinati i Drurit me sip. 6900 m2 | | | | | | | | | | |

| Problematika / mungesë dokumentacioni | Dok. ligjor për përcaktimin e z. kadastral të origjinës | Sip. e kthyer (kompensuar fizikisht) përfundimtare | | | | | | Sip. për kompensim përfundimtare | | | | | | | | | | | VLERËSIMI FINANCIAR |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| | | Sipërfaqja m² totale | Zëri kadastral i origjinës | | | | Zona kadastrale | Sipërfaqja m² totale | Zëri kadastral i origjinës | | | | Zona kadastrale | Zëri kadastral aktual | | | | | |
| | | | Zëri kadastral - truall | Zëri kadastral - tokë bujqësore | Zëri kadastral - kullotë-livadh | Zëri kadastral - pyll | | | Zëri kadastral - truall | Zëri kadastral - tokë bujqësore | Zëri kadastral - kullotë-livadh | Zëri kadastral - pyll | | Zëri kadastral - truall | Zëri kadastral - tokë bujqësore | Zëri kadastral - kullotë-livadh | Zëri kadastral - pyll | | |
| VKKKP ESHTE PLOTESUAR ME VENDIMIN NR.180 DT.30.09.1997 DHE ME VENDIMIN NR.342 DT.24.09.2000; ZERI I ORIGJINES NUK PERCAKTOHET NGA DOK LIGJOR NE DOSJE | | 1052 | | 1052 | | | 8250 | 1763.6 KOMPENSIM + 9176 PARABLERJE | | 1763.6 + 9176 | | | 8250 | 10939.6 | | | | | 0 |
| | Vendim gjykate nr. 2287, dt. 4.11.1993, flet per ish toke bujq. | 1120 | | 1120 | | | 8522 | 5870 parablerje | | 5870 | | | 8522 | 5870 | | | | | 0 |
| | vertetim arkivor nr. 260, viti 1993 / nuk ndodhet ne dosje/ nuk percaktohet. TOKE BUJQESORE SIPAS HARTES SE IGJF VITI 1941 | 264.5 (96 + 168.5 bashkpronesi dhe sipas nenit 12) | | 264.5 | | | 8582 | 462.5 (444 komp.+ 18.5 parablerje) | | 462.5 | | | 8582 | 462.5 | | | | | 0 |
| | Referuar notes se transkriptit nr. 6536, dt. 9.3.1938 ne bllokun 16 figuron nje cope toke 657.5 m2. Referuar hartes 37-38 zeri kadastral i origjines eshte toke bujqesore.; Referuar hartes 37-38 zeri kadastral i origjines eshte toke bujqesore | 157.5 | | 157.5 | | | 3215;8514 | 0 dhe Parablerje:499.50 | 0 | 499.5 | 0 | 0 | 3215;8514 | 499.5 | 0 | 0 | 0 | | 0 |
| Referuar dokumentacionit te pronesie, vendim nr. 203, dt. 21.03.1994, konkretisht ne pjesen arsyetuese te tij prona figuron pjeserisht bujqesore dhe pjeserisht livadh. | ZERI KADASTRAL I ORIGJINES TOKE BUJQESORE SIPAS HARTES SE VITIT 1937 | 2993 | | 2993 | | | 1347;2593 | 0 dhe Parablerje:23487.00 | 0 | 23487 | 0 | 0 | 1347;2593 | 23487 | 0 | 0 | 0 | | 0 |
| | VERTETIM DT. 10.03.1994 LESHUAR NGA SEKSIONI I KADASTRES | 924 | | 924 | | | 8592 | 1316 M2 PARABLERJE | | 1316 | | | 8592 | 1316 | | | | | 0 |
| NE LIDHJE ME TE DR. E PARABLERJES SUB. KA HUMBUR AFATIN LIGJOR PER HEQJE DORE PERKUNDREJT KOMPENSIMIT. VENDIMI | vertetim zotnimi nr. 312 - FLET PER BAHCE DHE VERTETIM KADASTRAL I CILI FLET PER 1820 M² PEMISHTE - NUK PERCAKTOHET ZERI KADASTRAL.Referuar hartes Qytete 1937-1938, prona rezulton toke bujqesore.; Referuar hartes Qytete 1937-1938, prona rezulton toke bujqesore. | 660 | | 660 | | | 1209;8593 | 62.00 dhe Parablerje:2140.00 | 0 | 2202 | 0 | 0 | 1209;8593 | 2202 | 0 | 0 | 0 | | 0 |
| | Referuar hartes IGJF-Topo-50000 te vitit 1941, hartes Topo-25000 te viteve 1950-1960 Toke Bujqesore. | 1312 | | 1312 | | | 2365;2364 | 560.00 dhe Parablerje:853.50 | 0 | 1413.5 | 0 | 0 | 2365;2364 | 1413.5 | 0 | 0 | 0 | | 0 |
| 1. Me vendimin nr. 385/4 date 29.02.1996 te KKKP eshte ndryshuar pika nr. 2 e VKKKP nr. 385/2 date 06.09.1994 duke i njohur gjithsej kompensim ne vlere per sip. 600 m2. 2. Ne hartat e vendimeve nr. 385/2 dhe 384/2 date 05.09.1994 janë kontruar të ndarë vetem siperfaqet e kthimit nga 5 000 m2 ndersa siperfaqja e njohur per kompensim dhe parablerja eshte lene nje pa u bere ndarja dhe pozicionimi per dy vendimet veç e veç | Referuar dokumentacionit ligjor ne dosje vertetim pronesie date 17.11.1993 nga Hipoteka Elbasan konstatohet se: zeri kadastral i origjines ka qene toke are | 5000 | | 5000 | | | 8523 | 600 + 6900 parablerja | | 7500 | | | 8523 | 7500 | | | | | 0 |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
| 10 | 29-08-1994 | SHKODER | Shkodër | | Muhamed Bekteshi | Hiqmet Bekteshi | 329 | 7 | 9 | 1994 | 5500 | 590 | 410 | 4500 | | | | | | | | | | |
| 11 | 02.12.1994 | Korçë | Korcë | Korcë | Kristaq Avushka | Kristaq Avushka | 494 | 9 | 9 | 1994 | 4000 | | 2898 | 1102 | | | | | | 769; 830 | | 2413 dt.10.07.1996; 4039 dt.20.12.1996 | | |
| 12 | 12-05-1994 | Elbasan | Elbasan | | Musa Peni, Mustafa Peni | SHEFQET PENI | 338/4 | 14 | 9 | 1994 | 6700 | 2860 | 500 | 3340 | | | | | | | | | | |
| 13 | 34396 | SHKODER | SHKODER | SHKODER | XHEMAL OMARI | FATOS OMARI | 370 | 12 | 10 | 1994 | 880 | | 631 | 241 | | | | | | | | | | |
| 14 | 29-09-1994 | DURRES | Krujë | | Muharrem Kota | Bukurie Dibrani | 137 | 24 | 10 | 1994 | 2500 | 148 | 0 | 2352 | | | | | | | | | | |
| 15 | 01-01-2003 | GJIROKASTE R | Dropull | | Thoma Prase | Niko Prase | 180 | 23 | 11 | 1994 | 2242 | 1414 | 276 | 552 | Nr:1018,Dt:29-07-2003,Institucioni:ZR KKP-KKKP | | | | | | | | | |
| 16 | 28-02-1994 | SHKODER | Shkodër | | Brahim Cuf Rrjolli | Berhan Rrjolli | 483 | 25 | 11 | 1994 | 10900 | 7945 | 175 | 2780 | | | | | | | | | | |
| 17 | 29.09.1993 | DURRES | KRUJE | KRUJE | ISUF ELBASANI | GONXHE ELBASANI | 141 | 29 | 12 | 1994 | 3628.5 | 2167 | 1300 | 161.5 | | | | | | | | | | |
| 18 | 01-01-1993 | Korçë | Pogradec | | Hamet Çollaku | Aris Çollaku | 228 | 2 | 2 | 1995 | 5613 | 1831 | 0 | 3782 | | | | | | | | | | |

| | | | | | | | | | | | | | | | | | | |
|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|---|
